

**VENDIM I ASAMBLESE SË ORTAKËVE  
TË SHOQËRISË “SOUTH ADRIATIC DEVELOPMENT” SH.P.K.  
VENDIM NR. 5, DATE 23.12.2021**

Sot më datë 23.12.2021, në selinë e shoqërisë “South Adriatic Development” shpk ,në Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Ortakut të Vetëm të shoqërisë, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe në Statutin e Shoqërisë.

I pranishëm në mbledhje ishte Shoqëria “Smart Construction Invest” shpk, përfaqësuar nga Ortaku i saj i vetëm Z. Redi Struga dhe Shoqëria “Peninsula Development” shpk, përfaqësuar nga Ortaku i saj Shoqëria “GENERATE” shpk., në cilësinë e Ortakut të Vetëm të së cilës është Z. Andi Canaj. Mbas diskutimit të çështjeve në rendin e ditës, Ortakët e Shoqërisë “South Adriatic Development” shpk në vijim të ushtrimit të aktivitetit :

**V E N D O S Ë N:**

1. Miratimin e lidhjes së kontratës së shitblerjes së kuotave të Ortakëve të shoqërisë “South Adriatic Development” shpk duke aprovuar njëkohësisht shitjen e kuotave në masën 10 % të pjesëmarrjes të Ortakut Shoqëria “Peninsula Development” dhe blerjen e këtyre kuotave nga Ortaku tjetër shoqëria Smart Construction Invest” shpk. e cila bëhet pronare e kuotave të kapitalit të shitur.
2. Ngarkohet Administratorët e Ortakëve të Shoqërisë “South Adriatic Development” shpk të cilët janë Shoqëria “Peninsula Development” shpk dhe shoqëria “Smart Construction Invest” shpk për te negociuar dhe për të nënshkruar Kontratë Shitblerje të kuotave që do të lidhet midis Shoqërive sipas kushteve e termave të dakordësuara nga palët.
3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij dhe regjistrohet pranë Q.K.B.
4. Pas regjistrimit të këtij Vendimi dhe referuar kontratës për shitblerjen e kuotave, shoqëria “South Adriatic Development” shpk, do të ketë ndryshimet si më poshtë: Ortaku i saj Shoqëria “Peninsula Development” shpk do të ketë 1 kuotë me pjesëmarrje në përqindje 40 %, ndërsa Ortaku tjetër Shoqëria “Smart Construction Invest” do të ketë 1 kuotë me pjesëmarrje në përqindje 60% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
5. Ky Vendim nënshkruhet në 4 (katër) kopje identike.

**“SOUTH ADRIATIC DEVELOPMENT” SH.P.K.  
ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

Për “Peninsula Development” shpk  
Ortak i vetëm “Generate” shpk  
Z. Andi Canaj



Për “Smart Construction Invest” shpk  
Ortak i vetëm Z. Redi Struga

